

Thirrja nga data 18.03.2026 deri në datën 30.03.2026

TERMAT E REFERENCES

PËR

RESTAURANTE TË CILËT OFROJNË SHËRBIME BAZUAR NË KRITER E KËRKUARA PËR REALIZIMIN E PUNETORIVE TË ORGANIZATËS NEVO KONCEPTI.

Organizata	OJQ “NEVO KONCEPTI”
Objektiva	Përshkrimi i ofertës për akomodim, ushqim, salla e punetore dhe akomodimi.

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmije, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga muaji Tetor të vitit 2025 ka filluar të zbatojë projektin “Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” në Komunën e Prizrenit. Ky projekt synon të fuqizojë pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje përmes krijimit dhe funksionalizimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Asambleja Komunale e Fëmijëve përbëhet nga 45 anëtarë të zgjedhur nga 13 shkollat e mesme të ulëta të komunës së Prizrenit. Në përbërje të saj janë të përfaqësuar komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian. Gjithashtu, në Asambleshë Komunale të Fëmijëve marrin pjesë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilët kontribuojnë dhe angazhohen në aktivitetet e ndryshme që organizohen nga anëtarët e saj.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

“Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” është një projekt i implementuar nga OJQ Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children në Kosovë. Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe rritja e pjesëmarrjes së tyre në proceset vendimmarrëse në nivel lokal, gjatë hartimit të politikave dhe organizimit të aktiviteteve komunale.

Në kuadër të projektit, është mbështetur krijimi dhe funksionalizimi i Asamblesë së Fëmijëve në nivel komunal, e përbërë nga nxënës të 13 shkollave fillore të mesme të ulëta në komunën e Prizrenit.

Përveç Prizrenit, projekti zbatohet edhe në komunat e Suharekës, Dragashit dhe Rahovecit, duke kontribuar në fuqizimin e zërit të fëmijëve dhe përfshirjen e tyre aktive në vendimmarrje në nivel lokal.

Sqarim:

Në lidhje me aplikim për ofrimin e ofertave për shërbimet e cekura më poshtë mund të aplikojnë restaurantet të cilat përmbushin kriteret e kërkuara.

1. Detyrat dhe Përgjegjësit

- Mirëpritja e stafit dhe antarëve të cilët do të marrin pjesë në aktivitetin të cilin do të zhvillohet në Restuarant.
- Përgaditja e ushqimit sipas kërkesës, nga ana përfaqësuesve të OJQ "Nevo Konceptit".
- Salla e takimeve të plotsojë kushtet për zhvillimin e takimeve, trajnimeve dhe konferencave
- Përgatitja e faturës me kohe dhe pritshmëria e pagesës përmes transferit bankarë.
- Zbritja e TVSH-s në faturim bazuar në dokumentin e ofruar nga OJQ "Nevo Koncepti" e cila lirohet nga TVSH-ja në bazë të UA Nr.03/2015 për TVSH

Të punojë në përputhje me politikat e Nevo Konceptit, sa i përket Politikës për mbrojtjen e fëmijëve mbi respektimin e të drejtave të fëmijëve.

4. AFATI KOHOR

Njoftimi i përfaqësuesve të restorantit për zhvillimin e aktiviteteve të caktuara do të jetë dy ditë më parë para zhvillimit të aktivitetit për shkak të përgaditjes.

5. REZULTATET E PRITSHME

Bashkëpunim të mirëfillt.

- Ushqimi dhe pijet të jenë me qmime të njëjta gjatë periudhës së kontratës.
- Ushqimi dhe pijet të jenë kualitative.
- Përgatitja e ushqimit me kohë dhe i freskët,
- Salla e Konferencave të ketë kushtet të cilat i përmbushë për mbajtjen e aktivitetit.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:
Kërkesa për ofertë (të jetë e nënshkruar dhe e vulosur) Oferta
Kopja e dokumentit të ARBK-s së bizenit.

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 30.03.2025** në prokurimi@nevokoncepti.org